

Trajnim në temë “Zhvillimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit”

Nga 24 deri 26 tetor të vitit 2008 në Strugë u realizua trajnimi në temë “Zhvillimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit” me gjithsej 27 përfaqësues nga rajoni i Kërçovës dhe Dibrës. Trajnimi i përfshiu temat në vijim: partneritete, njoftim me partnerët e mundshëm, sjellja e vendimeve, administrim dhe marrëdhënie me opinionin, rrjete dhe koalicione, plan aksionar për formimin e rrjeteve/koalicioneve, partneritete për lobim dhe përfaqësim dhe realizimin e fushatave dhe formimin e partneriteteve me medime.

Trajnuesit Mario Veljković dhe Fatmir Saraçini e realizuan trajnimin për 17 përfaqësues nga OJQ-t nga Kërçova, Dibra dhe Qendra Zhupë, 5 përfaqësues nga institucione nga Kërçova, 2 përfaqësues nga vetëqeverisja lokale nga Kërçova dhe Vraneshtica, 2 përfaqësues nga Këshillat pranë Komunave të Kërçovës dhe Drugovës dhe 1 përfaqësues i mediumit lokal nga Dibra.

Trajnimi i cili përfshiu segmente teorike dhe ushtrime praktike për zbatimin e diturive dhe shkathtësive të fituara, u organizua nga Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit në Kërçovë dhe Dibër (Qendra për zhvillim të bashkësive Kërçovë dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bashkësisë Dibër, ish Qendrat për përkrahjen e OJQ-ve).

Nëpërmjet metodave aktive dhe pasive u zhvilluan kapacitet e pjesëmarrësve për analizë praktike të faktorëve, aktorëve dhe shfrytëzuesve në bashkësinë lokale dhe atë më të gjerë që kanë të bëjnë me çështje konkrete lokale dhe me bashkësitë etnike jo shumicë, u përpunuan hapat për planifikim dhe zbatim të aktiviteteve për lobim dhe fushatat. Njëkohësisht u definuan 5 tema/probleme aktuale të cilët mundën të jenë shkas për ringjalljen e partneriteteve ndër-sektoriale dhe rrjeteve.